



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA
DEPARTAMENTI I GJUHËVE SLLAVE DHE
BALLKANIKE



PROGRAMI I LËNDËS
Histori Turke

Ngarkesa: 20 Seminare, 20 Leksione, 4 Kredite

Viti / Semestri: Viti II, semestri I

Lloji i lëndës: Lëndë e detyrueshme

Programi i studimit: Bachelor – Gjuhë letërsi dhe qytetërim turk

Kodi i etikës: Kodi i etikës i UT-së (nenet 4, 6, 7, 9)

PËRMBLEDHJE DHE REZULTATET E TË NXËNIT

Objektivat e përgjithshme lëndore: Kjo lëndë pretendon të japë një panoramë të përgjithshme dhe praktike të punës kërkimore shkencore duke u marrë me tema të vecanta që prekin interesin e përgjithshëm, të parrahura më parë dhe që bazohen në punën në grup të studentëve

Objektivat specifike lëndore:

1. Të arrijë të marrë njohuritë bazë të të lëndës së historisë së Turqisë
2. Të mësojë të kërkojë dhe të organizojë e sistemojë informacionin
3. Të mësojë të planifikojë punën sipas etapave të caktuara
4. Të analizojë dhe të formojë një gjykim personal, të arsyeshëm dhe aktiv mbi burimet e ndryshme dhe literaturën e shfrytëzuar.

Rezultatet e pritshme :

1. Njohë dhe përshkruajë elementët kryesorë të historisë së Turqisë, duke përvetësuar njohuri bazë mbi zhvillimet historike, politike, shoqërore dhe kulturore.
2. Zhvillojë aftësi kërkimore, duke ditur të kërkojë, përzgjedhë dhe sistemojë informacionin nga burime të ndryshme akademike dhe mediatike.
3. Organizojë punën kërkimore në mënyrë të strukturuar, sipas etapave të përcaktuara (zgjedhja e temës, hulumtimi, përpunimi i materialit, prezantimi përfundimtar).
4. Përdorë teknika të thjeshta të analizës së burimeve, duke zhvilluar një qasje kritike ndaj literaturës së shfrytëzuar.